



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËSI KANALIZIME BASHKIA KAMËZ SH.A
KËSHILLI I ADMINISTRIMIT

PROÇES-VERBAL

I

MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË UJËSJELLËSI
KANALIZIME BASHKIA KAMËZ

Sot më datë 13.12.2017, ora 10:00, në selinë e përkohshme të shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz (UKBK), në Rrugën "5Maji" Këshilli i Administrimit të kësaj shoqërie u paraqit për pjesëmarrje në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë (Aksionarit të vetëm Bashkia kamëz), thirrur me shkresën e datës 22.11.2017 për tu zhvilluar me datë 13.12.2017, ora 10:00.

Në këtë mbledhje janë të pranishëm Anëtarët e Këshillit të Administrimit të shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sha:

Z.Mariglen Qato, Anëtar i Këshillit të Administrimit dhe Administrator i Përkohshëm i shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sha.

Z.Elvin Tivari, Anëtar i përkohshëm i Këshillit të Administrimit;
Z.Kostandin Mato, Anëtar i përkohshëm i Këshillit të Administrimit.

Këshilli i Administrimit konstatoi se Aksionari i vetëm edhe pse ka marrë dijëni sipas Formularit të postës së shpejtë AC Albanian Courier, në datë 22.11.2017, nuk është paraqitur.

Me njoftimin për thirrjen e mbledhjes së aksionarëve të shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz regjistruar me NIPT L72320034A, është përcaktuar rendi i ditës si vijon:

1. *Konstituimi i Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve (Aksionarit të vetëm) të Shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a;*
2. *Dorëheqja e anëtarëve të parë të Këshillit të Administrimit dhe Administratorit të parë të përkohshëm të shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a;*
3. *Zëvendësimi i anëtarëve të Këshillit të Administrimit të parë dhe administratorit të parë të përkohshëm të shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a;*
4. *Ndryshimi i selisë së shoqërisë;*
5. *Marrja në dorëzim e aktiveve neto që i përkasin shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a nga Raporti i ndarjes së shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a;*
6. *Dhënia e Autorizimit për ndjekjen e procedurave të licencimit të shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a;*

Në këto kushte, ky këshill administrimi i mandatuar deri në mbledhjen e parë të thirrur të Asamblesë së Aksionarëve të Ujësjellësi Kanalizime Bashkia Kamëz (datë 13.12.2017, me vendimin Nr.11, datë 13.11.2017 të Asamblesë së Aksionarëve të UKT sh.a gjatë miratimit të akteve të ndarjes së saj, në mungesë të konstituimit të Asamblesë, do të kërkojë në Qendrën Kombëtare të Biznesit që shoqëria të kalojë me status pasiv, të pezulluar dhe të depozitohet dorëheqjet e anëtarëve të Këshillit të Administrimit ku bën pjesë dhe Administratori i Përkohshëm, bazuar në ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit” i ndryshuar dhe nenet 24 dhe 25 të ligjit nr.129/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.

Në përfundim ky proces-verbal nënshkruhet nga të gjithë anëtarët.

Për Këshillin e Administrimit të Ujësjellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a

Z.Mariglen Qato, Anëtar i Këshillit të Administrimit dhe Administrator i Përkohshëm

Z.Elvin Tivari, Anëtar i Përkohshëm i Këshillit të Administrimit

Z.Kostandin Mato, Anëtar i Përkohshëm i Këshillit të Administrimit





ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE
UJËSJELLËS KANALIZIME BASHKIA KAMËZ SH.A
AKSIONARI I VETËM BASHKIA KAMËZ

V E N D I M

Nr. 01 datë 01/10/2019

Për

“Emërimin e Anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe Audituesit Ligjor/Ekspertit Kontabël të Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a”

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, dhe Statutit të Shoqërisë, Aksionari i vetëm i shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a, në mbledhjen e datës 01/10/2019.

V E N D O S I:

1. Emërimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a si më poshtë:

- Hasan Bara Anëtar
- Hajredin Murgu Anëtar
- Shpetim Leskaj Anëtar dhe Administrator/Drejtor i Përgjithshëm

2. Emërimin e Audituesit Ligjor/Ekspertit Kontabël të miratuar për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a për një periudhë 3-vjeçare si më poshtë:

- Vera Lala Liçensë Profesionale nr. 135 date 27.01.2005
- Valbona Merko Liçensë Profesionale nr. 137 date 28.01.2005

3. Ngarkohet Administratori i shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a, për regjistrimin e këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE
AKSIONARI I VETËM

BASHKIA KAMËZ
Z. RAKIP SËLI

KRYETAR



ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE
UJËSJELLËS KANALIZIME BASHKIA KAMËZ SH.A
AKSIONARI I VETËM BASHKIA KAMËZ

V E N D I M

Nr. 02 datë 01/10/2019

Për

“Miratimin e ndryshimit të Emrit dhe Selisë të Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a”

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, dhe Statutit të Shoqërisë, Aksionari i vetëm i shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a, në mbledhjen e datës 01/10/2019.

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të emrit së shoqërisë nga Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a në Ujësjiellësi Kanalizime Kamëz sh.a (UKK sh.a)
2. Miratimin e ndryshimit të Selisë së shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Kamëz sh.a nga Selia e regjistruar në adresën: **Rruga “5 Maji”, Tiranë**, në Selinë me adresë: **Bulevardi Blu, nr. 492, Kamëz**;
3. Ndryshimin e emrit dhe selisë në statutin e saj dhe regjistrimin e vendimit të ndryshimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
4. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE
AKSIONARI I VETËM

BASHKIA KAMËZ
Z. RAKIP SËLI

KRYETAR



**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE
TË SHOQERISË "UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ " SHA
AKSIONARI I VETËM BASHKIA KAMËZ**

V E N D I M

Nr. 7, datë 15.11.2021
PËR

**"LIRIMIN, MANDATIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT
TË UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ SH.A"**

Në mbështetje të nenit 135, pika 2, gërma c dhe nenit 154 të ligjit r.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shogëritë tregtare" i ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.63, datë 27.01.2016 "Per riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura"; Statutit të Shoqërisë, nenet 11 dhe 12,

V E N D O S I:

1. Lirimnin nga detyra e anëtarit të Këshillit të Administrimit të Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a, të:
 - Z.Shpëtim Leskaj Anëtar/Drejtor i Përgjithshëm
2. Mandatimin, si anëtar të Këshillit të Administrimit të Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a, të:
 - Z.Gentjan Murataj Anëtar/Drejtori Përgjithshëm
3. Lirimnin nga detyra e anëtarit të Këshillit të Administrimit të Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a, të:
 - Z.Hajredin Murgu Anëtar
4. Mandatimin, si anëtar të Këshillit të Administrimit të Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a, të:
 - Z.Ramadan Hysa Anëtar
5. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a me zbatimin e këtij vendimi dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERVE





**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE
TË SHOQERISË "UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ " SHA
AKSIONARI I VETËM BASHKIA KAMËZ**

V E N D I M

Nr. 8, datë 15 . 11 .2021

PËR

**"LIRIMIN NGA DETYRA TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHOQËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ SH.A DHE ZËVENDËSIMIN E TIJ"**

Në mbështetje të neneve 135, pika 2, gërma c dhe 158 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare " i ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr .63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm , grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura"; statutit të UKK sh.a, nenet 7 dhe 18, Asambleja e Aksionarëve e Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a,

V E N D O S I:

1. Lirim nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a të **Z. Shpëtim Leskaj**
2. Emërimin në detyrën Drejtorit të Përgjithshëm të Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a të **Z. Gentjan Murataj**
3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a me zbatimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

K R Y E T A R I





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE
UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ SH.A

V E N D I M

Nr. 11, datë 15.11.2021

**PËR SHTIMIN E ADRESAVE SEKONDARE PËR UJËSJELLËS KANALIZIME
KAMËZ SH.A**

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, Statutit të Shoqërisë së Ujësjiellës Kanalizime Kamëz sh.a, Aksionari i vetëm i shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Kamëz sh.a.

V E N D O S I:

1. Miratimin për shtimin e adresave sekondare në funksion të Ujësjiellës Kanalizime Kamëz sh.a, si mëposhtë:

- Rruga “Nato“, Ndërtesë 2-katëshe, Objekti Nr. 36, Valias, Kamëz;
- Rruga “Demokracia“, Godinë 2-katëshe, Objekti Nr. 5, Kati i parë, Paskuqan, Kamëz;
- Rruga “Donald Trump“, Godinë 3-katëshe, Nr. 21, Frutikulturë, Kamëz;
- Rruga “Demokracia“, Godinë 2-katëshe, Nr. 19, Babrru, Kamëz;
- Rruga “Demokracia“, Godinë 2-katëshe, “Belba“, Kati i parë, Bathore 1, Kamëz;
- Bulevardi “Nënë Tereza“, Godinë 2-katëshe, Nr. 64, Kati i parë, Afër Fafës, Kamëz;
- Bulevardi “Nënë Tereza“, Nr. 492, Bashkia Kamëz, Kati I-rë, Kamëz;
- Bulevardi “Nënë Tereza“, Nr. 492, Pallati Kulturës, Zyra Adisa, Kamëz;

2. Ndryshimet e mësipërme, pasqyrohen në statutin e Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Kamëz Sh.a, bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjiellës Kanalizime Kamëz sh.a për zbatimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

K R Y E T A R I

RAKIP SULLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE
UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ SH.A

V E N D I M

Nr. 9, datë 15.11.2021

PËR ZËVËNDËSIMIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT TË
UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ SH.A

Në mbështetje të nenit 135, pika 2, gërma c, dhe nenit 157, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Statutit të Shoqërisë së Ujësjetllës Kanalizime Kamëz sh.a, Aksionari i vetëm i shoqërisë Ujësjetllësi Kanalizime Kamëz sh.a.

V E N D O S I:

1. Mandatimin e Z. **Prel Gjonpalaj**, në funksioni e Anëtarit të Këshillit të Administrimit të Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a;
2. Lirimn e Z. **Hasan Bara**, nga funksioni i Anëtarit të Këshillit të Administrimit të Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a;
3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjetllës Kanalizime Kamëz sh.a për zbatimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

K R Y E T A R I

RAKIP SULA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE
UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ SH.A

V E N D I M

Nr. 10 , datë 15.11.2021

**PËR MIRATIMIN E EKSPERTËVE KONTABËL PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE
TË ZMADHIMIT TË KAPITALIT TË UJËSJELLES KANALIZIME KAMËZ SH.A**

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Vendimit nr.63, datë 27.01.2016 të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, Ligjit 25/2018, “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Vendimin Nr 18, datë 19.09.2019 të Këshillit të Bashkisë Kamëz “Për miratimin e marrëveshjes për ndarjen e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a dhe marrjen në dorëzim të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a”, Statutit të Shoqërisë së Ujësjetllës Kanalizime Kamëz sh.a, Aksionari i vetëm i shoqërisë Ujësjetllësi Kanalizime Kamëz sh.a.

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurave për zmadhimin e kapitalit themeltar me vlerën e aktiveve materiale të drejtave e detyrimeve të pasqyruar në regjistrat kontabël të Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a dhe Ndërmarrjes së Ujësjetllës Kanalizime Bashkia Kamëz;
2. Miratimin e Znj. **Leze Abazi**, si Eksperte Kontabël, me liçencë nr.24, datë 10/02/2000, për hartimin e raportit të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a;
3. Largimin si Ekspert Kontabël të autorizuar, të regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Bisnesit për subjektet **Sokol Toska** dhe **MAZARS**;
4. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjetllës Kanalizime Kamëz sh.a për zbatimin e këtij vendimi dhe depozitimin e tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

K R Y E T A R I

RAKIP SULI

